



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2019:144785

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 00393763

**P.nr.63/19**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, duke vepruar në **çështjen penale ndaj të akuzuarit V. H. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së Nr.04/L-082**, të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren sipas aktakuzës PP/II.nr.992-6/18 të dt. 27.06.2019, me dt. 21.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.992-6/18 e dt. 27.06.2019, e ngritur ndaj të pandehurit si më poshtë:

**V. H.** nga i ati F., e ëma H., i lindur më datë..., me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit.

**II.** Hudhja e aktakuzës bëhet për veprën penale vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale** që ka arritur me datën 20.09.2023.

**III.** Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

**IV.** Pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të realizoj në kontest civilo-juridik.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren ka akuzuar A. O. nga fsh..., Komuna e Dragashit, R. B. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe V. H. gjithashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, sipas Aktakuzës PP/II.nr.992-6/18 e dt. 27.06.2019 si dhe me Kërkesë për dhënjën e Urdhërit ndëshkimor edhe atë për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së Nr. 06/L-074.

Kjo gjykatë duke vepruar fillimishtë sipas kërkesës së Prokurorisë në lidhje me dhënjën e Urdhërit Ndërkimor ndaj tre të pandehurve, me Aktgjykimin P.nr.63/19 të dt. 16.08.2019 e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të pandehurve iu ka shqiptuar dënim

me gjobë në shumën prej 100,00 (njëqind) euro, ndërsa pas pranimit të të njëjtit është ushtruar kundërshtim edhe atë vetëm nga i pandehuri V. H. ndërsa ndaj dy të pandehurve tjerë –A. O. dhe R. B., Aktgjykimi mbi Urdhërin Ndëshkimor ka marrë formë të prerë.

Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Dragash ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 12.12.2019 dhe të fundit me datë 06.03.2024 ( edhe atë gjithsejt për mëse 10 herë) në të cilën nuk është paraqitur i akuzuari nga aktakuza me konstatimin se jetonë jashtë vendit në Republikën e Francës e në adresë të panjohur, konstatim ky i fundit i dorëzuesit të gjykatës i datës 12.02.2024 dhe 28.02.2024.

Gjithashtu gjykata për këtë çështje penale juridike ka lëshuar edhe Urdhër arrest edhe atë disa herë edhe atë me datë 15.07.2021 dhe 07.09.2022, ashtu që pas kapjes së të njëjtit nga organet e ndjekjes të sillet në Gjykatë.

Gjyqtarja pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë çështje penale për të akuzuarin V. H., se do të kryente në bashkëryerje veprën penale vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duhet hedhur Aktakuza e lartë cekur e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm si dhe të pushoj procedurën penale, në kuptim të nenit 106 par. 1 nënpar. 1.5 të KPRK-së Nr.04/L-082 (ligj që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), ku është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmirret nëse kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale e dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, ndërsa me dispozitat e nenit 107 par. 8 të KPRK-së është përcaktuar se ndjeka penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), siç ka ndodhur në rastin konkret, bazuar në faktin se nga dita e fundit (20.09.2017) kur dyshohet se i akuzuari e kanë kryer veprën penale të kualifikuar sipas Aktakuzës së lartë cekur të Prokurorisë Themelore në Prizren, e gjerë me datë 21.03.2024 kanë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite, me çka vërtetohet se ka ndodhur parashkrimi absolut për ndjekje penale.

Sa i përket ligjit më të favorshëm të cituar nga prokuroria në aktakuzën PP/II.nr.992-6/18 e dt. 27.06.2019 se është më i favorshëm neni 313 par. 1 Kodit Penal Nr.06/L-074 në raport me ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e kualifikuar me nenin 325 par. 1 të tij respektivisht Kodit Penal Nr.04/L-082, gjykata konstaton se në të dy Kodet parashihet sanksion i njëjtë (edhe atë denim me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet), kurse me Kodin Nr.04/L-082 kur vije çështja të parashkrimi është më i favorshëm për të pandehurit ngase parasheh me nenin 106 par.1 nënpar. 1.5 mundësin e parashkrimit prej 3 (tre) vitesh nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim, ndërsa Kodi Nr.06/L-074 me nenin 99 par. 1 nënpar. 1.5 parasheh mundësin e parashkrimit të ndjekjes penale në afat prej 6 (gjashtë) viteve nga kryerja e veprës penale me më shumë se një (1) vit burgim.

Prandaj, meqenëse nga kryerja e veprës penale, vjedhje nga neni 325 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën veprë parashihet dënim me burgim deri në 3 (tre) vite, gjegjësisht nga data respektivisht dita e fundit 20.09.2017 e gjerë në marrjen e këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vite, atëherë Gjykata gjeti se ka ardhur gjerë të parashkrimi absolut i ndjekjes penale ndaj të akuzuarit V. H. nga fshati..., Komuna e Dragashit e kjo në kuptim të nenit 106 par. 1 nënpar. 1.5 e lidhur me nenin 107 par. 8 të KPRK-së.

Vëndimi mbi shpenzimet e procedurës penale u muarr komfor nenit 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil u muarr komfor nenit 462 par. 3 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e cekura më lartë e komfor nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH –  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2019:144785, 21.03.2024**

**Gj y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.